



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/15  
Datë: 22.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Ri-aprovet Raporti Vjetor Financiar për vitin 2019.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedoj Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Tërhiqet nga procedura e Kuvendit të Republikës së Kosovës Raporti Vjetor Financiar për vitin 2019 i aprovuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 06/15 datë 23.03.2020, i proceduar në Kuvend me Vendimin e Qeverisë Nr. 02/03 datë 06.06.2020.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Pasqyrat financiare për vitin 2019, janë aprovuar në Qeveri me Vendimin Nr. 06/15, datë 23.03.2020, dhe konfirmimit me Vendimin e Qeverisë Nr.02/03 datë 06.06.2020 dhe dorëzuara në Kuvend sipas afateve ligjore. Të njëjtat mund të rishikohen derisa nuk është përmbyllur auditimi dhe nuk është lëshuar opinioni përkatës në pajtim me legjislacionin në fuqi.


Gjatë fazës së auditimit dhe shqyrtimit të pasqyrave financiare vjetore nga Zyra Kombëtare e Auditimit, janë ngritur disa çështje që lidhen me trajtimin e të hyrave vetanake të bartura, përkatësisht burimit të financimit, sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik (SNKSP) të aplikueshme, të cilat me ligjin e buxhetit (tabelën 1) janë trajtuar si plan për pranime nga të hyrat e bartura, si burim i financimit të brendshëm për vitin 2019.

Me rastin e ri-aprovimit të këtyre pasqyrave financiare vjetore (2019), kemi të bëjmë vetëm me shpalosje dhe shënime plotësuese të të dhënave për buxhetin e planifikuar, përkatësisht aspektit të paraqitjes së burimit të financimit dhe refleksioneve përkatëse, ndërsa nuk ka ndryshim të pozicioneve të raportuara me raportin vjetor 2019. Gjithashtu, janë adresuar edhe disa çështje të natyrës teknike dhe jo materiale në kuadër të raportit vjetor financiar për vitin 2019, i cili në tërësinë e tij konsiderohet i rishikuar.

Ndërsa, të dhënat për ekzekutimin e buxhetit dhe raportimit të pozicioneve përkatëse nuk ka ndryshim meqë transaksionet janë raportuar sipas kërkesave të LMFPD dhe SNKSP.

Pas miratimit të raportit të rishikuar në pozicionet e lartpërmendura, i njëjti i plotë si raport i dorëzohet përsëri Kuvendit të Kosovës si dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit, i cili merret për bazë nga ZKA si raport final mbi të cilin edhe lëshon raportin dhe opinionin e Auditimit.

**Avdullah HOTI**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë